

02 Nr. Br. 352/10-10972/26/3
23.06.2026



Dragash - Dragaš

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



DATË/A:	23.06.2026
PËR/ZA/TO:	Bexhet Xheladini, kryetar i Komunës
CC:	Resul Fetahu, kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM :	Komisioni për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi ecurinë e hartimit të Draftregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01.Nr.060/01-22757-1/24

Ky Raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Iniciativa për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01.Nr.060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024, ka ardhur nga Kërkesa e KRM "Ekoregjioni" Sh.A. 01Nr.352/01-551/26, e datës 08.01.2026, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave. Kjo është pasuar me Kërkesën e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike 02Nr.352/01-970/26, e datës 20.05.2026, për formimin e Komisionit për rishikimin e kësaj Rregulloreje.

Komisioni për hartimin e Draftregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01.Nr.060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024, është formuar më datën 22.05.2026, me Vendimin e kryetarit të Komunës 02Nr.060/01-9701/26. Komisioni është formuar në përbërje prej tre anëtarësh dhe ka mbajtur dy takime përgjatë punës së tij për hartimin e Draftregullores, e cila është hartuar edhe me ndihmën dhe bashkëpunimin e ngushtë me zyrtarin ligjor të Komunës së Dragashit.

Draftdokumenti është shpallur për konsultim publik më datën **26.05.2026**. Konsultimi publik elektronik ka zgjatur pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga data **26.05.2026 deri më 10.06.2026**. Takimi i drejtpërdrejtë me qytetarë është mbajtur më datën **10.06.2026, e mërkurë**. Në këtë takim kanë qenë gjithsej **20 pjesëmarrës**, prej tyre **0 femra dhe 20 meshkuj**.

Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik, i publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook të Komunës:

Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik është publikuar në platformat zyrtare më **26.05.2026**.

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Njoftimi-i-protokolluar.pdf>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1LYqvBg92Q/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1EeRjn9tfS/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1LYqvBg92Q/>

Draftdokumenti i publikuar në rubrikën për konsultime publike:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Propozim-rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave.docx>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Propozim-rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave-SRB.docx>

Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-draftin-e-rregullores-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-per-menaxhimin-e-mbeturinave/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzana-je-javna-konsultacija-o-nacrtu-pravilnika-o-izmjename-i-dopunama-pravilnika-o-upravljanju-otpadom/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1CsCpYdmVy/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1Ew8iemeBw/>

Gjatë kohës sa draftdokumenti ka qenë në konsultim publik elektronik, janë pranuar tri (3) kërkesa/komente/sugjerime në formë elektronike. Në takimin e drejtpërdrejtë me qytetarët dhe grupet e interesit ka pasur gjithsej gjashtë (6) kërkesa/komente/sugjerime.

Tabela me të dhënat e përgjithshme

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar/pranuara pjesërisht/refuzuara
Konsultim elektronik dhe me shkrim	26.05.2026 deri 10.06.2026 / Pesëmbëdhjetë ditë	1 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa, komente/sugjerime	3
Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë dhe grupe të interesit	10.06.2026, 50 minuta	20 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime	6

Pjesëmarrja sipas përkatësisë gjinore dhe etnike

Metodat e konsultimit	Gra	Burra	Shqiptar	Boshnjak/ Goran	Të tjerë	Gjithsej
Konsultim elektronik dhe me shkrim	0	1	1	0	0	1
Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë dhe grupe të interesit	0	20	16	1/3	0	20

Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për përmbajtjen e draft-dokumentit	Statusi i kërkesës / sugjerimit (e pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Propozoj që, në vend të 7.50€, tarifa për amvisëri të jetë 6.50€.	Veton Halili – përfaqësues i fshatit Zaplluxhe	Pranohet	Komisioni do ta shqyrtojë mundësinë që ta përgjysmojë tarifën e propozuar nga KRM “Ekoregjioni”.
2.	1. Pastrimi i deponive ilegale.	Dilber Halimovic – përfaqësues i fshatit Mlikë	Pranohet pjesërisht	Komuna e Dragashit, ië intervale të caktuara kohore e bën pastrimin e deponive ilegale nëpër zona të caktuara. Mirëpo, derisa nuk kemi një zgjidhje përfundimtare për ndërtimin e dy deponive të planifikuara, kjo çështje do të nxjerr edhe më tutje vështirësi procedurale dhe buxhetore për Komunën.
3.	1. Grumbullimi i mbeturinave nëpër fshatra nga “Ekoregjioni” të bëhet më shumë se një herë në javë; 2. Nga “Ekoregjioni” të bëhet një herë në muaj mbledhja e mbetjeve inerte nëpër fshatra.	Beqir Beqaj – drejtor i Radio Sharrit	Adresohet Pranohet pjesërisht	Kjo çështje është e rregulluar me Rregullore e cila interferon në tërë Kosovën, andaj kjo do të adresohet si propozim në nivelet e tjera të vendimmarrjes. KRM “Ekoregjioni” ofron vetëm shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të amvisërisë dhe çështja e mbeturinave inerte do të zgjidhet nga Komuna, e cila është në procedurë të formimit

				të dy deponive për mbetje inerte, një në pjesën e Opojës dhe një në pjesën e Gorës.
4.	1. Inspektimi dhe sanksionimi i qytetarëve që hedhin mbeturina nëpër deponi ilegale.	Sehat Ibraimi – përfaqësues nga Dragashi	Pranohet pjesërisht	Në kuadër të kompetencave të saj, Komuna do të intensifikojë inspektimet në lokacionet problematike dhe do të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së sistemeve të monitorimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo masë e tillë do të zbatohet duke respektuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parimin e proporcionalitetit dhe rekomandimet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Paralelisht, Komuna do të vazhdojë kontrollet inspektuese, identifikimin e ndotësve dhe shqiptimin e masave sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.
5.	1. KRM “Ekoregjioni” të raportojë para qytetarëve dhe Kuvendit për shërbimet, të hyrat dhe shpenzimet, numrin e konsumatorëve etj.	Burim Piraj – kompania MEKA	Pranohet	Kompania do të raportojë më detajisht në mbledhjen e Kuvendit, ku si pikë e rendit të ditës do të diskutohet edhe Draftregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së mëparshme.

Kërkesat/komentet elektronike

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për përmbajtjen e draft-dokumentit	Statusi i kërkesës / sugjerimit (e pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Vendosja e kamerave dhe dronëve për identifikimin e kompanive dhe qytetarëve që hedhin mbeturina nëpër deponi ilegale;	Saim Yzeri – qytetar	Pranohet pjesërisht	Në kuadër të kompetencave të saj, Komuna do të intensifikojë inspektimet në lokacionet problematike dhe do të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së sistemeve të monitorimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo masë e tillë do të zbatohet duke respektuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parimin e proporcionalitetit dhe rekomandimet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Paralelisht, Komuna do të vazhdojë kontrollet inspektuese, identifikimin e ndotësve dhe shqiptimin e masave sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.
	2. Vendosja e shportave nëpër rrugët kryesore të fshatrave dhe kontraktimi i një kompanie për pastrimin e tyre.		Pranohet	Komuna e mbështet këtë propozim dhe do ta shqyrtojë mundësinë e vendosjes së shportave në lokacionet më të frekuentuara të fshatrave, në përputhje me prioritetet dhe buxhetin e planifikuar. Mirëmbajtja dhe zbrazja e tyre do të organizohen përmes shërbimeve komunale ose

	3. Largimi i kanalizimeve nga lumenjtë.		Pranohet	operatorëve të kontraktuar sipas procedurave ligjore në fuqi. Komuna e konsideron mbrojtjen e lumenjve prioritet të rëndësishëm dhe do të vazhdojë angazhimin për identifikimin dhe eliminimin gradual të shkarkimeve të ujërave të zeza në lumenj, në bashkëpunim me institucionet dhe operatorët përgjegjës, në përputhje me mundësitë teknike dhe financiare. Deri më tani janë bërë investime të rëndësishme në këtë drejtim, sidomos me projektin e Impiantit për përpunimin e ujërave të zeza në fshatin Brezne.
--	---	--	----------	---

Në këtë Raport janë të bashkëngjitura:

1. Vendimi për formimin e Komisionit për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave;
2. Lista me nënshkrimet e pjesëmarrësve; dhe
3. Fotografitë.

Përgatiti:

Grupi Punues



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality
Kryetari i Komunës



02Nr. 352/01-9701/26
Dt. 22.05.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

- I. Formohet Komisioni për plotësim – ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, në përbërje prej:
 1. Redžep Ibraimi - kryesues
 2. Fari Kolloni – anëtar
 3. Nazim Dauti – përfaqësues nga Ekoregjioni – Dragash.
- II. Detyrë e Komisionit është që të bëjë plotësim ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave me nr. të protokollit 01Nr.060/01-22757-1/24 e dt. 30.08.2024 dhe të ndjek të gjitha proceduat ligjore për konsultime publike dhe të e dërgojë në Kuvend për miratim.
- III. Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Ekoregjionit – Dragash
- Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Beqet Xheladini





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 10.06.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIMIN PUBLIK PËR
RREGULLOREN PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E RREGULLORES
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 01.NR.060/01-22757-1/24 E
DATËS 30.08.2024

LISTA UÇESNIKA NA JAVNOJ RASPRAVI ZA PRAVILNIKA O DOPUNI
I IZMENI PRAVILNIKA O UPRAVLJANJU OTPADOM BR. 01.NR.060/01-
22757-1/24 OD 30.08.2024. GODINE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etniçka priпадnost	M	Ž	Potpis
1	BURIM PIRATI	PLAVE	SHQIPTAR	✓		
2	Basim HADRI	Kosovë	Shqiptar	✓		
3	ARBIT KALANDARI	KOSOVË	Shqiptar	✓		
4	Dreni Myrkez	ZAPLUXH	SHQIPTAR	✓		
5	Veton Halili	Zapluxhe	Shqiptar	✓		
6	Prendi Prenica	Buce	Kosovar	✓		
7	Eutidin Sanderi	DILANCE	GORANAC	✓		
8	DILBER HADIMOVIC	MAJKE	GORKANAC	✓		
9	Behim Vekop	Shkup	Shqiptar	✓		
10	Armond Sylmanin	Plac	Shqiptar	✓		
11	Engel Dhamir	Zapluxhe	Shqiptar	✓		
12	Behar Selmani	KUR	Shqiptar	✓		
13	Ushin Berisha	Buce	Shqiptar	✓		
14	Rafael Kalloni	Kosovë	Shqiptar	✓		
15	Faki Kalloni	Kosovë	Shqiptar	✓		
16	JASHAT IBRAHIM	ORNG.	Gor.	✓		
17	Sulejman	Rixha	Bosht	✓		
18	BEQIR BEQAT	Bellubrac	Shqiptar	✓		
19	Gedmond Komari	BIRUT	Shqiptar	✓		
20	Adem Enim	Zgatur	Shqiptar	✓		
21	REPUBLIKA E KOSOVËS					
22	REPUBLIKA KOSOVA					

Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02.Nr. Br. 352/01-10172/26/1
10.06. 2026
Dragash - Dragaš

